



“ZAN'ART” - FRYMËZIM, HISTORI DHE KUJTIM I TRADITËS!

Eventi ZAN'ART, dëshmoi se artizanati shqiptar mund dhe duhet të kthehet në një burim të qëndrueshëm zhvillimi ekonomik. Rreth 40 artizanë nga e gjithë Shqipëria sollën mjeshtërinë e tyre në një ekspozitë ku u ndërthur tradita me kreativitetin bashkëkohor. Nga poçeria e punuar me dorë që pasqyron teknika të trashëguara brez pas brezi, te filigrani delikat në argjend që shndërrohet në vepra arti, nga qëndisjet tradicionale që ruajnë simbolet dhe ngjyrat e krahinave shqiptare, te punimet unike në dru dhe qelq, gjithçka u prezantua me dinjitet dhe vlerë. Nuk munguan as produktet artizanale nga lesh, lëkurë dhe tekstil, si dhe punime kreative “Made in Albania”. Ky event është vetëm fillimi i një rruge që synon të kthejë trashëgiminë kulturore në një motor të gjallë të ekonomisë sonë.



“ZAN’ART” - PLATFORMË PËR PROMOVIMIN DHE MBËSHTETJEN E ARTIZANATIT SHQIPTAR.

Në fjalën e saj, Znj. Laura Saro, Drejtor Ekzekutiv i AIDA-s, theksoi se artizanati është dëshmia më e gjallë e lidhjes me rrënjët tona kombëtare dhe bëri thirrje për bashkëpunim mes institucioneve, artizanëve dhe partnerëve për të mbështetur këtë sektor me vlera të mëdha identitare.



Znj. Afërdita Onuzi, nënvizoi rëndësinë e artizanatit si dokument i gjallë i qytetërimeve të hershme dhe lidhjeve kulturore e tregtare ndër shekuj.



Ministri i Ekonomisë Kulturrës dhe Inovacionit, Z. Blendi Gonxhja e cilësoi artizanatin si një prioritet strategjik, duke theksuar se ky është vetëm fillimi i një rruge që synon të kthejë trashëgiminë kulturore në një motor të gjallë të ekonomisë sonë.



ZAN’ART është një hap konkret drejt njohjes së artizanatit jo vetëm si pjesë e trashëgimisë, por edhe si një potencial real për zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm të vendit. Kjo ditë e shënuar bëri bashkë:

- ✓ Mbi 100 tregtarë apo individë të interesuar për zhvillimin e këtij sektori;
- ✓ Mbi 200 pjesëmarrës;
- ✓ 40 Biznese artizanale;
- ✓ Përfaqësues nga institucione të ndryshme shtetërore;



“ZAN’ART” – 4 Workoshop-e artizanale

Përmes workoshope-ve mjeshtrat e artizanatit prezantuan produktet dhe bizneset e tyre përballë një audience të përzgjedhur si agroturizëm dhe target grupe të interesuara për sektorin e artizanatit duke i mundësuar zgjerimin e tregjeve.

Mjeshtrat e zanatit gjatë eventit ZAN’ART ndanë me ne sekretet e talentit të tyre duke na dhuruar emocion. Çdo workshop, çdo mësim i dhënë me durim, ndez zjarrin e kuriozitetit dhe bën ëndrrat realitet për brezat e rinj.



“ZAN’ART” – Një hap konkret drejt fuqizimit të artizanatit shqiptar

Gjatë eventit Zan’ArT, një ndër momentet më të rëndësishme ishte zhvillimi i një tryeze diskutimi me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të institucioneve dhe artizanëve, e fokusuar në identifikimin e sfidave dhe nevojave të sektorit të artizanatit.

Të pranishëm në tryezë ishin:

- Blerta Rama – Zëvendësministre e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI)
- Sokol Sinjari – Sekretar i Përgjithshëm i Dhomës Kombëtare të Zejtarisë
- Përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Artizanët ndanë nga afër sfidat me të cilat përballen, si dhe kërkesat për mbështetje konkrete në promovimin e produkteve, fuqizimin e kapaciteteve dhe pjesëmarrjen në tregje të reja.

Tryeza synoi krijimin e një dialogu të hapur mes institucioneve dhe komunitetit artizanal, me qëllim që të ndërtohen hapa të përbashkët për zhvillimin e këtij sektori që ruan dhe promovon trashëgiminë kulturore shqiptare.



Platforma EXPORT ALBANIA

Platforma EXPORT ALBANIA është instrumenti mundësues i Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA), e zhvilluar në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI) dhe me German Agency for International Cooperation (GIZ), për të fuqizuar bizneset shqiptare në ekspozimin dhe hyrjen në tregje globale.

Kjo platformë u konceptua si një zgjidhje strategjike për të mbështetur ndërkombëtarizimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, duke fuqizuar misionin e AIDA-s për të ofruar shërbime me vlerë të shtuar që lidhen ngushtë me eksportin dhe rritjen e aktivitetit tregtar të sipërmarrjeve shqiptare në tregjet ndërkombëtare. E ndërtuar për të shërbyer si një mekanizëm promotor shumë-dimensional, EXPORT ALBANIA i siguron eksportuesve shqiptarë rritjen e njohurive mbi përfitimet e ekspozimit ndërkombëtar, zhvillimin e aftësive për përthithjen e shpejtë të kuadrit ligjor dhe krijimin e lidhjeve të nevojshme për të qënë konkurrues në tregjet ndërkombëtare.

Ju ftojmë të vizitoni faqen online të platformës: <https://exportalbania.al/>



AIDA priti në një takim zyrtar përfaqësuesit e Enterprise Greece dhe përfaqësues nga Ambasada Greke

Në vijim të aktivitetit të suksesshëm Match Maker Albania 2025, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) priti në ambientet e saj në një takim zyrtar përfaqësuesit e Enterprise Greece, agjencisë homologe për promovimin e investimeve në Greqi, si dhe përfaqësues nga Ambasada Greke.

Takimi u zhvillua në frymën e bashkëpunimit të ngushtë ekonomik mes dy vendeve, me qëllim ndjekjen e mundësive të identifikuara gjatë eventit Match Maker Albania 2025 dhe forcimin e marrëdhënieve institucionale për nxitjen e investimeve të ndërsjella.

Gjatë diskutimeve, palët ndanë informacion mbi interesin e shtuar të kompanive greke për tregun shqiptar, sektorët prioritarë me potencial për bashkëpunim dhe hapat konkretë për lehtësimin e kontakteve mes bizneseve.

Të dyja agjencitë ranë dakord të vijojnë bashkëpunimin për organizimin e aktiviteteve të përbashkëta promovuese, si dhe për shkëmbimin e informacionit strategjik mbi sektorët me interes dhe praktikatat më të mira në mbështetjen e investimeve.





Rekord në Investime të Huaja Direkte në Shqipëri për 2024!

Shqipëria ka arritur një performancë të fortë në tërheqjen e IHD-ve, si në fluks ashtu edhe në stok, gjatë viteve të fundit.

Fluksi i investimeve të huaja direkte në vitin 2024 ka arritur €1.6 miliardë, një shifër rekord. Krahasuar me vitin 2023, ka pësuar një rritje prej €84 milionë ose +5.6%.

Turqia dominon fluksin me 16.2%, ndërsa aktiviteti ekonomik që dominon është Aktivitete të pasurive të paluajtshme me 24% të fluksit total.

Stoku i IHD-ve për vitin 2024 ka arritur €15.4 miliardë, gjithashtu një rekord. Krahasuar me vitin 2023, ka shënuar një rritje prej €2.2 miliardë ose +16.2%.



AIDA mirëpriti Delegacionin e Investitorëve Italianë nga Regione del Veneto

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) zhvilloi një takim me Delegacionin e Investitorëve italianë nga Regione del Veneto, të shoqëruar nga z. Arben Shkodra. Takimi u drejtua nga znj. Laura Saro, Drejtoreshë Ekzekutive e AIDA-s.

Gjatë takimit u diskutua interesi i investitorëve për të zhvilluar projekte në Shqipëri dhe u prezantuan mundësitë që vendi ynë ofron për investime. AIDA shprehu gatishmërinë për të ofruar mbështetje të mëtejshme dhe asistencë të personalizuar për çdo investitor.

Ky takim synon forcimin e bashkëpunimit ekonomik mes Shqipërisë dhe Italisë, me fokus në zhvillimin e projekteve konkrete investimi.



AIDA zhvilloi takim me Bankën Islamike për Zhvillim në kuadër të organizimit të “Tirana Investment Conference”.

Në kuadër të përgatitjeve për organizimin e “Tirana Investment Conference”, një nga ngjarjet më të rëndësishme për promovimin e mundësive investuese në Shqipëri, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) zhvilloi një takim me përfaqësues të Bankës Islamike për Zhvillim (IsDB).

Takimi kishte në fokus forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe angazhimit të partnerëve strategjikë në mbështetje të konferencës, me qëllim tërheqjen e investitorëve potencialë nga vendet anëtare të IsDB dhe më gjerë.

Përmes kësaj konference, AIDA synon të prezantojë potencialet kryesore që ofron Shqipëria për investime në sektorët prioritarë, duke krijuar ura të reja bashkëpunimi mes investitorëve ndërkombëtarë dhe institucioneve shqiptare.



Trajnimi Level Up with EEN Albania

Trajnimi ‘Level Up with EEN Albania’ nisi me sesionin e parë: Ligji 29/2023 dhe akses në financë. Një seancë plot informacione të vlefshme për të kuptuar më mirë si të rrisim mundësitë financiare dhe të përshtatemi me ndryshimet ligjore.

‘Level Up with EEN Albania’ vijoi me sesionin e dytë: Marketingu Digjital dhe Prokurimet Publike. Një seancë shumë praktike dhe plot këshilla mbi mënyrat më efektive për të promovuar biznesin dhe për të shfrytëzuar mundësitë në tregun publik.

‘Level Up with EEN Albania’ vijoi me sesionin e tretë: Sfidat e eksportit. Një seancë plot informacione ku trajnuam së bashku për të çuar bizneset shqiptare në një tjetër nivel.

Në përfundim, pjesëmarrësit u pajisën me certifikatë për angazhimin dhe përkushtimin e treguar.



AIDA dhe ABSL Albania në vizitë aftercare pranë Kineton Albania

Në kuadër të fushatës Aftercare për vitin 2025 në sektorin ICT/BPO, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), në bashkëpunim me ABSL Albania, zhvilloi një vizitë pranë kompanisë Kineton Albania.

E themeluar dy vite më parë në Tiranë, Kineton Albania është shndërruar shpejt në një aktor kyç në sektorin automotiv, duke ofruar zgjidhje inteligjente për industrinë e automjeteve dhe duke sjellë risi në përmirësimin e përvojës së konsumatorit. Si degë e kompanisë italiane Kineton, me mbi 500 punonjës në disa shtete europiane, Kineton Albania është specializuar në shërbime të avancuara si HiL testing, validim elektronik dhe produkte të zhvilluara nga kërkimi dhe nevojat e klientëve.

Vizita shërbeu për të identifikuar mundësitë konkrete të mbështetjes institucionale dhe nxitjes së mëtejshme të zhvillimit të sektorit teknologjik në vend.



Shpallet thirrja për “Panairin e Ushqimit dhe Jetesës së Shëndetshme” në datat 4- 7 dhjetor 2025, do të zhvillohet në Zagreb, Kroaci

AIDA ju bën me dije se në datat 4- 7 dhjetor 2025, do të zhvillohet në Zagreb, Kroaci, “Panairi i Ushqimit dhe Jetesës së Shëndetshme”

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve ju bën me dije se në datat 4- 7 dhjetor 2025, do të zhvillohet në Zagreb, Kroaci, “Panairi i Ushqimit dhe Jetesës së Shëndetshme” i fokusuar në temën e ushqimit, të jetuarit të shëndetshëm dhe rikthimit në natyrë dhe stileve të shëndetshme të jetesës. Prezantimi në Panairin e Zagrebit është një mundësi ideale për të promovuar dhe prezantuar industrinë ushqimore, prodhuesit e ushqimit etj.

Ftohen kompanitë shqiptare të prodhimit të ushqimit të ekspozojnë të gjitha produktet ushqimore, për shembull qumështin dhe nënproduktet e qumështit, djathin, frutat dhe produktet e frutave, çokollatën dhe nënproduktet e çokollatës, produktet e arrave, ullinjë dhe vajin e ullirit, perimet e freskëta dhe të ngrira, mishin dhe nënproduktet e mishit, verë, ujë, birrë, liker, pije joalkoolike, ëmbëlsira, mjaltin, ushqimet organike etj.

Broshura: <https://lnkd.in/ecYKyGD4>

Llojet e produkteve: <https://lnkd.in/esEKvqrK>

Formulari i regjistrimit: <https://lnkd.in/ezatXxgB>



AIDA ju prezanton me thirrjen më të re të publikuar: Erasmus for Young Entrepreneurs (EYE)

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve vijon informimin e të gjithë palëve të interesuara mbi publikimin e skemave të reja financiare, në kuadër të mbështetjes së ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme.

Në portalin “Akses në Financë” mund të gjeni thirrjen më të re të publikuar: Erasmus for Young Entrepreneurs (EYE)

Për t'u njohur me thirrjen, kushtet e pranimit, masën e financimit dhe më shume, vizitoni platformën në linkun: <https://lnkd.in/eeWqEBMM>.

Shpallet thirrja për Panairin Ndërkombëtar “Halal Expo Sarajevo 2025”, në datat 17-19 qershor 2025, në Sarajevë të Bosnje-Hercegovinës.

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, Ju fton të bëheni pjesë e Panairit Ndërkombëtar “Halal Expo Sarajevo 2025”, i organizuar në bashkëpunim me Agjencinë për Certifikimin e Cilësisë Hallall në Bosnje dhe Hercegovinë, i cili do të zhvillohet në datat 17-19 qershor 2025, në Sarajevë të Bosnje-Hercegovinës.

Qëllimi i këtij panairi, është të ndihmojë kompanitë të rrisin shitjet duke i prezantuar produktet dhe shërbimet e tyre blerësve nga bota arabe dhe Azia Juglindore dhe të forcojë rolin e Bosnje dhe Hercegovinës si një urë natyrore midis Evropës dhe botës myslimane në fushën e produkteve dhe shërbimeve hallall.

Kompanitë dhe vizitorët e interesuar mund të marrin informacion shtesë për Panairin, duke përfshirë dhe informacionin se si të regjistroheni për pjesëmarrje, përmes faqes zyrtare: <https://lnkd.in/eNvaYmMN>, përmes adresës së postës elektronike: info@halalexposarajevo.com ose numrit të telefonit: +38762200220.

AIDA ju prezanton me thirrjen më të re të publikuar: “EIC Transition 2025”

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve vijon informimin e të gjithë palëve të interesuara mbi publikimin e skemave të reja financiare, në kuadër të mbështetjes së ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme.

Në portalin “Akses në Financë” mund të gjeni thirrjen më të re të publikuar: “EIC Transition 2025”.

Për t’u njohur me thirrjen, kushtet e pranimit, masën e financimit dhe më shumë, vizitoni platformën në linkun: <https://lnkd.in/eNwXT9bK>.



AIDA ju prezanton me thirrjen më të re të publikuar: “EIC Pathfinder 2025”.

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve vijon informimin e të gjithë palëve të interesuara mbi publikimin e skemave të reja financiare, në kuadër të mbështetjes së ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme.

Në portalin “Akses në Financë” mund të gjeni thirrjen më të re të publikuar: “EIC Pathfinder 2025”.

Për t’u njohur me thirrjen, kushtet e pranimit, masën e financimit dhe më shumë, vizitoni platformën në linkun: <https://lnkd.in/et3acbEx>.

